

V E N D I M
Nr.369, datë 26.7.1993

**PËR RIORGANIZIMIN E SHËRBIMIT TË DEZINFEKTIMIT, DEZINSEKTIMIT DHE
DERATIZIMIT (DDD)**

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shërbimi i dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit duke filluar nga data 1.9.1993 kalon në vartësi të organeve të pushtetit lokal (bashkive dhe komunave).
2. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë të bëjnë kalimin e fuqisë punëtore, bazës materialo-teknike dhe fondeve të planifikuara për këtë shërbim, organeve të pushtetit lokal.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.484, datë 27.12.1988, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1.9.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRVE
Aleksandër Meksi